



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 16.10.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me grupet e interesit lidhur me shqyrtimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9942, datë 26.06.2008 “Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizimin e njeriut” të ndryshuar”.
(Komision për dhënie mendimi)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Halil Jakimi, Besnik Baraj, Eglantina Gjermeni, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Robert Bitri, Andrea Marto, Tatiana Nurçe, Ilir Ndraxhi, Arben Pëllumbi, Dritan Bici, Kujtim Gjuzi, Zef Shtjefni dhe Alban Zeneli.

Mungojnë:

Lefter Koka, Gjetan Gjetani, Arlind Çaçani, Halit Valteri dhe Nimet Musaj.

Të ftuar:

Alban Zusi – Drejtues i Shoqatës së Industrialistëve Shqiptarë

Drini Shkreli – Përfaqësues i Eurofish-it

Kujtim Shkreli – Përfaqësues i Eurofish-it

Roland Kristo – Zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Antoneta Njehrrëna – Drejtoreshë e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Albana Fico – Drejtoreshë e Institutit të Shëndetit Publik në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Vjollca Braho - Drejtoreshë e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Jolanda Hyska – Përfaqësuese e Institutit të Shëndetit Publik

HAPET MBLEDHJA

Niko Peleshi – Mirëdita!

Në rendin e ditës së seancës së fundit parlamentare ishte për diskutim dhe miratim projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr. 9942, datë 26.06.2008 “Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizimin e njeriut” të ndryshuar”, i cili ka pasur komision përgjegjës Komisionin e Shëndetësisë, ndërkohë, është gjykuar që të kalojë për dhënie mendimi edhe në komisionin tonë, për shkak se është një projektligj, që afekton jo vetëm fushën e shëndetit publik, por edhe sektorin e prodhimit vendas për eksport.

Për këtë arsye, ne po fillojmë të japim mendimin tonë për këtë projektligj në një dëgjesë me grupet e interesuara.

Të ftuar kemi zotin Alban Zusi, drejtues i Shoqatës së Industrialistëve Shqiptarë, zotin Drini Shkreli nga Eurofish. Gjithashtu, kemi të ftuar edhe nga kompani të tjera të interesuara, të cilat nuk janë këtu ose mbase janë duke ardhur, por ne nuk mund të presim më gjatë, sepse orari ishte në orën 11:00. Në qoftë se do ta shikojmë të arsyeshëm, do ta vazhdojmë konsultimin edhe me grupe të tjera të interesuara në formën e shoqatave, të kompanive apo institucioneve të interesuara për çështjen.

Do të mirëpresim rekomandimin e zotit Zusi në lidhje me mënyrën se si do ta qasim marrëdhënien me grupet e interesuara, në mënyrë që mendimi ynë për komisionin dhe për seancën parlamentare të jetë sa më i kujdesshëm dhe të reflektojë interesin e shëndetit publik, por edhe pa dëmtuar sektorin e përpunimit të ushqimeve në vendin tonë.

Urdhëroni!

Ilir Beqaj – Për të qenë sa më eficientë, nëse të gjithë ata që kemi njoftuar nuk vijnë sot, t’i njoftojmë nëse mund të na i dërgojnë me shkrim komentet që kanë që të bëhemi gati për diskutimet e tjera.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Po, edhe kjo qëndron, por dua të them që t’u bëjmë një shkresë, ku t’ju kërkojmë mendimin e tyre me shkrim ose në qoftë se dëshirojnë, të dëgjohen, sepse, me sa shikoj, nuk janë ftuar të gjithë aktorët. Nuk e di se sa prej tyre përfaqëson shoqata e industrialistëve. Di që përfaqëson një pjesë të mirë të sektorit. Por, në qoftë se ka organizime të tjera jashtë organizimit të shoqatës, t’u japim hapësirën për t’i dëgjuar këtu, qoftë duke i lexuar komentet e dërguara me shkrim.

Urdhëroni, zoti Gjuzi!

Kujtim Gjuzi – Faleminderit, zoti kryetar!

Mendoj se ata që janë njoftuar dhe që kanë interes të jenë këtu përpara komisionit tonë, duhet të vijnë këtu, kurse me shkresa i bie që ne t'u lutemi të tjerëve. Mendoj se zotërinjtë, që janë këtu, janë treguar seriozë, pra zotërinjtë të harxhojnë pak kohë në lidhje me projektin që kemi përpara.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Shumë e drejtë, por kam përshtypjen se, duke qenë se koha ka qenë e shkurtër, nuk janë njoftuar të gjithë ata, që mund të jenë të interesuar, sepse ky sektor i përpunimit të ushqimeve është shumë i gjerë dhe nuk e di sa kohë kemi pasur për t'i lajmëruar të gjithë operatorët.

Kujtim Gjuzi – Atëherë, le ta shtyjme, të marrim kohë më shumë, nëse është defekti ynë!

Niko Peleshi – Unë propozoj që të bëjmë dy dëgjesa, në qoftë se është e nevojshme. Pra, dëgjojmë ata që janë pjesëmarrës sot, më pas bëjmë një dëgjesë tjetër. Kjo nuk është urgjente. Ky është një projektligj që, me sa di unë, ka 1 vit e gjysmë që përgatitet, kështu që, nëse do të vonohemi edhe një javë, nuk është ndonjë urgjencë e madhe.

Sot këtu në mbledhje kemi përfaqësues shumë të rëndësishëm të sektorit, pra drejtuesin e shoqatës, që ka shumë anëtarë brenda. Ne sot mund të marrim një mendim të qartë dhe të vlefshëm për diskutimet tona, mbase joshterues, por për ta shteruar bëjmë diskutime të tjera ose administrojmë pretendimet e tyre me shkrim.

Zoti Zusi, fjala për ju.

Alban Zusi – Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

E vlerësoj shumë ftesën tuaj. Uroj që takime të tilla të jenë më të shpeshta, sepse industritë vërtet kanë nevojë që të dëgjojnë. Duke ditur dhe duke besuar në vullnetin pozitiv, besoj se mund të bëjmë shumë gjëra të mira për të kthyer entuziazmin ekonomik.

Për t'u futur drejtpërdrejtë në temë, duke respektuar edhe kohën tuaj, qëndrimi ynë lidhur me këtë çështje është si më poshtë:

Pa diskutim që vendimmarrja për ta jodizuar kripën, për të përmirësuar shëndetin e qytetarëve, veçanërisht në zonat rurale, ku mundësia për ta marrë jodin është e kufizuar me mjete dhe me ushqime të tjera, siç është peshku e të tjera, është një ndër vendimmarrjet më të mira që janë bërë ndonjëherë në fushën e shëndetit. Në këtë pikëpamje, nuk ka asnjë lloj diskutimi për sa kohë që flitet për kripën, që shkon drejtpërdrejt te konsumatori fundor. Në mënyrë absolute ajo duhet të jetë e jodizuar për të garantuar shëndetin e tij.

Objeksioni që ne kemi ndaj ligjit ekzistues dhe që do të donim të konsiderohej në ligjin e ri, është edhe marrja në konsideratë e funksioneve të tjera të kripës, si element përbërës, pasi kripa nuk ka vetëm funksion jetik, por ka edhe funksione konservuese. Në industrinë ushqimore, veçanërisht në industrinë e përpunimit të peshkut apo të përpunimit të nënprodukteve të tjera, të nënprodukteve të mishit (kur them nënprodukte mishi, nuk kam parasysh sallamrat, por kam parasysh nënproduktet që i shkojnë për përpunim të mëtejshëm në industri, siç janë të brendshmet e të tjera) do ta shpjegoj shumë shkurt pse përdoret kripa. Në këto lloje funksionesh kripa nuk është më një element që shkon dhe konsumohet nga organizmi i njeriut, por kryen rolin e konservantit. Në momentin që kryen rolin e konservantit, kërkesa, siç është aktualisht në ligj për ta jodizuar, së pari, na rrit koston me 10%-15% që është kostoja e jonizimit; dhe këtu flasim për sasi.

Kostoja e kripës automatikisht shkon në koston e produktit final, por këtu po flasim për industri, të cilat përdorin mijëra tonelatë kripë individualisht. Pra, kemi 10 fabrika të mëdha peshku, ku secila prej tyre përdor mbi 1 mijë tonë kripë në vit. Ky është problemi i parë, më pas ka edhe forma të tjera të përdorimit të kripës, siç mund të jetë kripa e shtrimit të rrugëve, por edhe forma të tjera të përdorimit të saj. Për shembull, kripa për larjen e lëkurës, e regjien e lëkurës, pra ka shumë funksione të tjera të kripës, të cilat nuk kanë lidhje fare me konsumatorin fundor. Pra, kripa shërben thjesht si konservant, më pas në proceset e tjera teknologjike ajo shpërllahet, largohet nga produkti dhe konsumatori fundor nuk ka asnjë lloj kontakti me këtë lloj kripe. Në këtë rast problemi i parë është kostoja, pra ne nuk kemi nevojë, sepse nuk ka arsye, që të rrisim kostot e produktit flasim në totalin e përdorimit nga industria ushqimore. Po flas vetëm për industrinë ushqimore. Nuk e di se çfarë ndodh në industrinë e të tjera, që mund të kenë përdorim të kripës. Por vetëm në industrinë ushqimore impakti është disa qindra mijë euro në vit, të cilat e bëjnë industrinë tonë më pak konkurruese, krahasuar me konkurrentët tanë rajonalë, që nuk e kanë këtë lloj detyrimi. Pra, nuk e ka këtë detyrim operatori kroat, nuk e ka këtë detyrim operatori maroken, egjiptian apo i grek, me të cilët konkurrojmë në rajon e të tjera me radhë.

Së dyti, bazuar edhe në Kodin Doganor për sa kohë flasim për mallra që shpeshherë janë mallra nën regjim, pra janë mallra që hyjnë për t'u rieksporuar, nuk ka pse ky lloj malli t'i nënshtrohet legjislacionit specifik shqiptar dhe për sa kohë në Itali, atje ku dërgojmë mallrat tona, edhe në ato raste kur kripa inkorporohet në produkt, nuk e kemi detyrimin që patjetër të kemi përdorur kripë të jonizuar, asnjëherë nuk na ka lindur një kërkesë e tillë.

Shpeshherë importojmë si operatorë për shkak të kërkesave për kripë cilësore, sepse operatorët vendas jo gjithmonë arrijnë të na i plotësojnë standardet tona. Jo më larg se sot

kisha një ofertë për kripë guri nga Gjermania. Për shkak të kërkesave për kripë të thatë, e cila të mos na shkrihet në produkt e të tjera, shpeshherë jemi të detyruar të blejmë kripë nga jashtë ose të paktën për produkte specifike. Por në të gjithë këto raste ne hasemi me barrierat doganore. Pavarësisht se kripa futet nën regjim, pra futet për t'u riekportuar mbi bazën e një karte teknologjike, praktikisht, ne fusim një mall që nuk është shqiptar, nuk ngelet shqiptar thjesht tranzitohet, përsëri duhet të deklarojmë, ose duhet të kemi një kripë, e cila duhet të respektojë një kërkesë dhe një standard vendas, ndonëse nuk nacionalizohet në asnjë moment të saj. Ne kemi diskutuar, sepse kjo është një histori e gjatë. Ne kemi mbi 7-8 vjet që ballafaqohemi me doganat.

Në fakt, doganat na kanë dhënë të drejtë dhe na kanë thënë: “Bazuar në Kodin Doganor, për sa kohë ky është një mall nën regjim, hyn dhe del, nuk ka pse t'i nënshtrohet legjislacionit sanitar vendas”. Por ky lloj mirëkuptimi nuk është gjetur nga institucionet sanitare, ndoshta edhe nga frika, nga hezitimi i tyre, për sa kohë në ligj ka një përcaktim taksativ, që çdolloj kripe që hyn në territorin e Shqipërisë, duhet të jetë...

Niko Peleshi – Zoti Zusi, më falni për ndërprerjen, por zoti Baraj ka diçka!

Besnik Baraj – Meqenëse jemi në një pikë, ku të paktën unë formalisht shikoj një mospërputhje të kësaj që thoni me këtë që pasqyrohet në ligj. Po ju lexoj draftin e ligjit, a i plotëson kërkesat tuaja? Bazuar në këtë draft, ju jepni argumentin tuaj që kjo formë nuk e justifikon atë që thatë ju. Në nenin 3, thuhet: “Lejohet përdorimi i kripës së pajodizuar në prodhimin e ushqimeve, përgatitja e të cilave parashikon domosdoshmërisht përdorimin e kripës së pajodizuar. Këto ushqime përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe ministrit përgjegjës për ushqimin. Lejohet eksporti i kripës së pajodizuar dhe i ushqimeve të prodhuara me kripë të pajodizuar në vende, ku nuk ekziston ndalimi i përdorimit të kripës së pajodizuar”. Kjo nuk e realizon dot pretendimin që ju thatë?

Faleminderit!

Alban Zusi – Faleminderit, zoti Baraj!

Në finale e realizon, por na e bën shumë të komplikuar, sepse i bie që secila industri duhet të shkojë dhe të marrë një autorizim të posaçëm, pra të vërtetojë pranë atij komisioni të përbashkët që kripa ka këta funksione e të tjera. Ne mendojmë se një deklaram pranë doganës ose pranë institucionit tatimor mbi bazën e kartës teknologjike, sepse ne të gjithë jemi të kontrolluar dhe të menaxhuar mbi bazën e kartës teknologjike, pra ajo na monitoron...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk duhet të ketë licencë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më pas, kjo e bën më të komplikuar historinë, sepse, ne përveç licencave profesionale të punës që kemi, duhet të fillojmë të marrim licenca edhe për kripën. Kjo mund të jetë një mënyrë...

Robert Bitri – Ka licencën që e lejon të...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ajo licenca jote që t'i merresh me konservimin, automatikisht të klasifikon dhe lejohesh ta përdorësh...

(Diskutime pa mikrofon)

Ka subjekte që nuk u duhet kripa e jodizuar dhe përdorin për konservimin, siç janë frutat dhe perimet. Besniku është shumë në rregull. Unë mendoj se e zgjidh.

(Diskutime pa mikrofon)

Arben Pëllumbi - Për ta bërë pak të qartë për të gjithë, ndoshta për ata që na ndjekin. Nevoja e këtij projektligji pikërisht vjen nga fakti se është vënë re që në popullatën tonë kemi një mungesë të përdorimit të jodit, e cila ndikon drejtpërdrejt në shëndetin e popullatës. Kështu që ne si ligjvënës dhe ju si operatorë të interesuar duhet të gjejmë një pikë kontakti për t'i realizuar qëllimet e përbashkëta. Ju e vutë në dukje në fillim që nuk jeni kundër përdorimit të kësaj gjëje. Atëherë, këtij projektligji i janë bërë disa ndryshime nga drafti fillestar, i cili ka marrë parasysh edhe interesat tuaja, por duke marrë parasysh interesin dhe qëllimin kryesor, për të cilin po bëhen këto ndryshime, që është përdorimi i kripës së jodizuar. Pse? Sepse është mënyra më pak e kushtueshme për ta çuar jodin te qytetarët. Çdo mënyrë tjetër për ta përcjellë jodin te qytetari është gjithmonë edhe më e shtrenjtë. Pra, gjykohet se kripa është procesi që e çon jodin te qytetari në mënyrën më të thjeshtë të mundshme. Kështu që këtë pjesë ne nuk e diskutojmë që duhet bërë. Nuk duhet të përdoret te konsumatori final kripë e pajodizuar. Si e bëjmë për ta thjeshtuar edhe procedurën tuaj? Besoj se në këto pika, ashtu siç po ngul këmbë edhe Besniku, janë marrë parasysh edhe shumica e gjërave: lejohet, nuk ndalohet, pra: "Lejohet përdorimi i kripës së pajodizuar në prodhimin e ushqimit, lejohet rieksporimi". Kam përshtypjen se duhet të gjejmë një mekanizëm të vogël, por kjo duhet propozuar nga ju, për të thjeshtuar procedurën kur këto makina vijnë në doganë, ku merret edhe mostra për të bërë analizën e kësaj kripe, sepse kam përshtypjen se ju do të keni edhe elemente të tjera, të cilat kanë një lloj kufizimi kur vijnë në doganë. Besoj se këtu hyn edhe kripa. Pra, e kemi çështje procedure, nuk e kemi çështje koncepti. Besoj se për konceptin jemi të gjithë të qartë.

Alban Zusi – Faleminderit!

Edhe një herë e rikonfirmoj qëndrimin tim, që është ndër vendimmarrjet më të mira jodizimi i kripës për qytetarët. Atëherë duhet të ketë me një përcaktim që të na i bëjë jetën e thjeshtë, pra të mos shkojnë nëpër zyra për të marrë autorizim dhe të t'i themi faleminderit dikujt për këtë gjë që po bëjmë dhe për të gjitha procedurat e tjera me radhë. Ne në autorizimet tona doganore, që i bëjmë një herë në vit, paraqesim mallrat që duam të fusim nën regjim për t'u riekportuar dhe në këto mallra ne fusim edhe kripën, ku themi: “Gjatë këtij viti unë do të importoj 500 tonë kripë ose 1 mijë tonë kripë, e cila është e shoqëruar gjithmonë me kartelën teknologjike sesi përdoret”. Pra, ne nuk mund të marrim asgjë nën regjim pa dërguar kartën teknologjike që për X ton prodhim janë përdorur X ton kripë, e cila herë pas here verifikohet nga dogana. Pra, po flasim për një proces, i cili është i deklaruar dhe i kontrolluar nga dogana. Për shembull, ne mund të themi që përdorim 200 tonë kripë për një ton produkt final dhe mbi bazën e këtij regjimi dogana na ndjek. Pra, në qoftë se ne kemi nxjerrë 2 tonë produkt final, atëherë ti mund të importosh 400 tonë kripë, jo më shumë, sepse...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, raporti i kartës teknologjike.

Ne duam që nënin që sapo përmendi profesor Baraj ta bënim kështu: “Kripa e importuar nga industritë për t'u ripunuar për qëllime industriale dhe jo për t'u tregtuar te konsumatori fundor mund të jetë e pajodizuar”. Kjo na e zgjidh neve problemin. Nëse dikush prej nesh bën gafë dhe e tregton këtë kripë, pastaj ai merr të gjitha penaltitetet e mundshme. Ky mund të ishte formulimi që mund të na e thjeshtësonte punën.

Robnert Bitri – Ka një shprehje të specifikuar aty: “Vetëm për fortifikim”...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi –Zoti Pëllumbi, fjala për ju.

Arben Pëllumbi- Në pikën e parë, ku thuhet se lejohet importimi i kripës, ka të bëjë ekskluzivisht për kripën që do të shkojë te konsumatori final dhe për këtë jemi të gjithë dakord, por ne po flasim për dy paragrafët e tjerë, ku bëhet përjashtimi...

Ilir Beqaj – Pse është kështu paragrafi i parë?!

Arben Pëllumbi- “Lejohet importi i kripës ushqimore të pajodizuar vetëm me qëllim fortifikimin e kripës në vend”. Kjo është kryesorja, që kripa do të jodizohet. Kalojmë te përjashtimet...

Ilir Beqaj – Më fal që po ndërhyj, por nuk kalojmë te përjashtimet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për çfarë vjen kripa në Shqipëri?! Për t'u përdorur e gatshme, për t'u përdorur si përbërës në industrinë ushqimore dhe për gjëra të tjera. Po rrimë te këto përdorime dhe nuk po kalojmë te lëkurët rrugët e të tjerë. E njëjta gjë ndodh edhe në qoftë se prodhohet këtu, sepse fillimisht kripa prodhohet e pajodizuar, nuk ka rëndësi nëse del nga një fabrikë apo ka ardhur në kufi. Kur kripa vjen e pajodizuar për ushqim, ajo ose do të dalë me paketimin 200 gramë apo 500 gramë nëpër markete, ose do të shpërndahet nëpër restorant, ose do të shkojë tek ata që përpunojnë peshkun, mëlçinë e të tjerë. Këtu thuhet se po erdhi në doganë, shkon vetëm për fortifikim dhe, po shkoi për fortifikim, këta e blejnë të fortifikuar, por është 50% më shtrenjtë. Ky është thelbi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Besnik Baraj – Ka produkte që nuk duhen jodizuar fare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Besnik Baraj – Ka produkte deti që po u shtove jod ka një hiperjodizim dhe bën dëm. Veçanërisht tregu eksportues nuk e pranon këtë lloj hiperjodizimi dhe thotë: “Unë e dua me këtë lloj kripe”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sigurisht, ai që ushqehet kryesisht me këtë lloj produkt deti, i bën dëm.

Roland Kristo – Së pari, dua t'ju them se 100 gramë karkaleca deti është e barabartë me normën e dy ditëve që i duhet njeriut. Pra, është dyfishi i normës ditore.

Së dyti, ne po flasim për prodhimet e peshkimit në det, nga vjen edhe jodi dhe, po t'i shohim të tre paragrafët e shtuar në pikën e dytë, lejohet përdorimi i kripës së pajodizuar për industrinë përpunuese, sipas një udhëzimi të përbashkët të të dyja ministrive, por ku do ta gjejnë këta kripën?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vetëm në fabrikë vendi, tek Albvlora, gjë e cila na limiton.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Drini Shkreli – Edhe unë jam dakord që të përdorim prodhimin e vendit dhe mundësisht të vendosim edhe limitime për të përdorur vetëm produktin e vendit, por problemi është se fabrika e Vlorës, që ne do të donim shumë, sepse të gjithë kemi punuar me të, ende nuk prodhon me cilësinë që duam ne dhe nuk na jep pastërtinë. Neve po na u gjend jashtë shtetit diçka e vogël e zezë në produkt na kthehet i gjithë loti mbrapsht dhe ai nuk na e garanton këtë pastërti. Ajo fabrikë na garanton pastërtinë deri në 99,5%, por që ajo përqindja 0,5 neve na nxjerr jashtë tregut. Këtu shitet kripa me 90 euro tonin, ndërsa në Gjermani ne e blejmë me 147 euro tonin dhe nuk jemi budallenj ta blejmë 50 euro më shumë, por është ai

rreziku, ajo gjëja e zezë, që neve s'na jep siguri. Pra, ne e blejmë kripën e Vlorës për shëllirë, për përdorim masiv dhe për kriposje, që më pas e shpëljajmë, por kur duhet ta fusim në produkt dhe të shkojë te konsumatori fundor në Europë, ne hezitojmë. Ata nuk janë konkurrues në cilësi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Roland Kristo – Dua të flas për pjesën e rieksportuesve, sepse është pjesa që na prek më shumë. Rieksporti të mos kërkohet të licencohet për përjashtim, por të jetë automatikisht i përjashtuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lejohet importi i kripës ushqimore të pajodizuar...

Drini Shkreli – Paragrafi i parë duhet të riformulohet.

Roland Kristo – Pra, “Të lejohet importi i kripës ushqimore të pajodizuar, me qëllim fortifikimin e kripës në jod dhe nga ata operatorë ekonomikë, që prodhojnë ushqime, sipas përcaktimeve të parashikuara nga paragrafi i tretë”. Pra, ata operatorë, të cilët nuk kanë nevojë....

(Ndërhyrje pa mikrofon)

“Në prodhimin e ushqimeve, përgatitja e të cilave parashikon domosdoshmërisht përdorimin e kripës së pajodizuar”. Pra, për ato produkte që kërkohet domosdoshmërisht kripa e pajodizuar ne kemi një autorizim për të importuar mall, i cili del, siç edhe e shpjegoi zoti Zusi, i gjithi për rieksport. Ky mall kontrollohet nga dogana për çdo kilogram që del dhe u nënshtrohet rregullave të vendit ku shkon, në këtë rast BE-së, por mund të ketë edhe rregulla specifike dhe, nuk mund t'i imponohet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi - Po, zoti Beqaj.

Ilir Beqaj - Dua ta shoh më gjerë këtë, sepse në thelb, tani që po e shikoj, ne vazhdojmë me zgjidhje të sforcuara të problemeve, që nuk i zgjidhim dot në mënyrë normale. Për mua ky është një lloj moratoriumi. E kemi bërë këtë debat vitin që shkoi kur vendosëm taksën nga ambalazhi i plastikës tek e gjithë plastika. Tatimet na thanë që nuk e mbledhin dot taksën vetëm për ambalazhin, kështu që ia vendosëm të gjithë plastikës. Sipas një studimi serioz dhe të pavarur nga UNICEF-i, ne kemi një problem real shëndetësor të mungesës së jodit te shqiptarët, shumë më të ndjeshëm te fëmijët dhe, nga rreziku që nuk kontrollojmë dot kripën që konsumohet duam t'i vëmë klon kësaj historie. Unë kam përshtypjen se nuk është kjo mënyra sesi duhet ta zgjidhim, por është një mënyrë tjetër. Të paktën, me sa lexova, te neni 7 i projektligjit, te koncepti i gjurmueshmërisë, e shkruara këtu vetëm gjurmueshmëri

nuk është, kjo është një arkivë. Në qoftë se duam të bëjmë gjurmueshmëri, sot nuk është e vështirë për ta bërë. Ne mund të mos e bëjmë gjurmueshmërinë me gjurmim gjeografik, sepse bëhet fjalë për jo më shumë se 20-25 subjekte në të gjithë Shqipërinë, të cilat për nevojat e tyre janë shumë të avancuara nga ana e teknologjisë ushqimore dhe teknologjisë së informacionit, por mund ta bëjmë me një portal, ku pasqyrohen të gjitha hyrjet dhe daljet e të gjitha kripërave që hyjnë në Shqipëri, kemi 5 lloje kripërash, bëjmë një magazinim të të gjitha loteve që hyjnë dhe dalin në Shqipëri dhe e zgjidhim këtë punë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo është arsyeja pse nuk ta bën dogana, sepse, po të ishte kështu, dogana do të na e bënte vjet taksën e ambalazhit të plastikës. Kokrrat e plastikës importohen për ambalazh dhe humbin pastaj, importoheshin 10 njësi dhe shiteshin 9 njësi. Shqetësimi i drejtë mund të jetë kur vjen kripa e pajodizuar ose e jodizuar me kontroll dhe një pjesë shkon te përpunimi i peshkut e një pjesë del në treg, por, duke qenë se ne nuk jemi në gjendje të kontrollojnë çdo minimarket fshati për llojin e kripës që shet, duam të vendosim klon, që për mua është e pasaktë dhe e padrejtë. Po të ishte për doganë nuk do të bënte bota gjurmueshmëri, por do të bënte vetëm territor doganor. Gjurmueshmëria ndodh në çdo hallkë kur gjëja vendoset në treg nga dogana apo fabrika, sepse është edhe fabrika. Po fabrikën kush e kontrollon?! Nga fabrika del e pajodizuar dhe shkon jodizohet ose për konsum, ose shkon për industri ushqimore, por mund të shkojë edhe në disa industri të tjera dhe, ngaqë aty nuk ka monitorim dhe licencim, mund të bëhen shumë gola.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për mua kjo histori është shumë e sforcuar, zoti kryetar, neni 12/1 pika 2, që edhe po të jetë me dokumente të rregullta nga BE-ja, duhet t'i bëjmë prapë analizat, më duket pak si...

Kam edhe një shqetësim tjetër që lidhet me nenin 4 të projektligjit, i cili prek nenin 12. Ministri i Bujqësisë para pak ditësh ka prezantuar një rishikim, që po i bëhet inspektimit të ushqimit dhe të shëndetësisë dhe, ende nuk është ndarë se çfarë kalon nga sot që e ka shëndetësia tek ushqimi. Prandaj mendoj të mos avancojmë me nenin 4 pa e pasur të qartë si do të reformohet AKU-ja dhe ISHSH-ja. Ndoshta duhet t'i kërkojmë qeverisë një opinion se çfarë do të bëhet me këto dy institucione, sepse, nëse nuk gabohem, ministri e shpalli para disa ditësh.

Faleminderit!

Besnik Baraj – Duke u mbështetur në komentet që bëri zoti Beqaj dhe duke mos dashur të aludoj se mund të bëhet për të favorizuar dikë, dua të them se paaftësinë e sistemit të analizave për të monitoruar të gjithë këtë proces ne nuk mund ta veshim me ligj. Pra, siç e

tha ndryshe Iliri, ne nuk mund të vendosim klone. Kjo vazhdon më tej edhe te neni 12/1, ku detyron një subjekt apo çdo lloj subjekti, që importon kripë, pavarësisht se ajo shoqërohet me një fletë analize që vjen nga Holanda, Franca, Gjermania e të tjerë, të kryejë detyrimisht për çdo porcion që vjen këtu analizën dhe ta marrë koston vetë. Kjo bie në kundërshtim edhe me OBT-në, edhe me marrëveshjen CEFTA-s. Ti nuk mund të diskriminosh vetëm një produkt për ta analizuar detyrimisht subjektin, në një kohë që ne kemi produkte ushqimore, që kanë peshë konsumi shumë më të madhe në ushqimin ditor të njeriut dhe mund të jenë subjekt i produkteve toksike dhe kontaminimit në procesin e prodhimit, në procesin e magazinimit dhe në procesin e përpunimit. Po marr si shembull vetëm cerealet, grurin, kafenë e të tjerë, të cilat janë subjekt i kontaminimit me mykotoksina, ku ti nuk e detyron subjektin të bëjë këto analiza. Edhe peshku që importohet, qoftë i ngrirë, qoftë në konserva, mund të përmbajë metale të rënda dhe ti nuk e detyron dot atë të hapë konservën dhe të analizojë përmbajtjen e mërkurit në një kohë që ai ka fletëanalizën shoqëruese. Më duket absurde që ne të detyrojmë subjektet për të bërë analiza. Shteti ka organizma analitikë dhe monitorues. Aty ku problematika është jetike, siç është rasti i jodit në Shqipëri, le të bëjë sondazhe dhe kontrole me një frekuencë të caktuar, pastaj të penalizojë subjektin, në ato raste kur ky subjekt nuk ka respektuar atë që parashikohet në ligj.

Faleminderit!

Drini Shkreli – Ne po flasim për kompanitë e mëdha që importojnë dhe të gjitha këto kompani kanë një sistem gjurmueshmërie mjaft të avancuar që, nuk po them çdo kilogram, çdo lloj identifikohet dhe është pothuajse e pamundur që të bëhen manovrimet apo të merren sasi të mëdha kripe dhe të ikë në destinacion të paditur. Kompanitë e mëdha duhet t'i marrin këto sasi të mëdha kripe të pajodizuar dhe t'u fshihen të gjitha autoriteteve për të fituar 5% të vlerës. Kjo është shumë e shtirur dhe, siç e thatë edhe ju, është përgjegjësi e autoriteteve kompetente, si AKU-së apo Tatimeve që të kontrollojnë nëse ne po e përdorim këtë kripë sipas legjislacionit. Ne si industri që e marrim kripën nuk mund të paragjykojemi dhe mund ta përdorim për gjëra të tjera. Nëse e marrim për ta përdorur për gjëra të tjera, ka të tjera institucione që na kontrollojnë dhe na penalizojnë.

Niko Peleshi – Zoti Gjuzi, urdhëroni!

Kujtim Gjuzi – Faleminderit, zoti kryetar!

Si do të donit ju ta formulonit nenin 3?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, sepse nuk doli e qartë. Kishte diversitet mendimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A je bërë me ne të opozitës? Çfarë ke që na del kundër? Jemi bashkë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ke ardhur.

Roland Kristo – Në nenin 3, te paragrafi i parë, ku thuhet: “Lejohet importimi vetëm për qëllime fortifikimi” propozimi është: “Lejohet importimi i kripës ushqimore të pajodizuar” dhe ndahet paragrafi në “a” dhe “b”. Në rastin e parë “a” për fortifikim dhe në rastin e dytë “b” nga ata operatorë ekonomik që prodhojnë ushqime, sipas përcaktimeve të parashikuara nga paragrafi i tretë i këtij neni, të cilët e kryejnë përdorimin e saj për procese teknologjike të përpunimit me qëllim eksportin e produktit të caktuar.

Niko Peleshi – Mendoj se është e nevojshme të bëjmë një sqarim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, të bëj një sqarim.

Kam përshtypjen se ne po diskutojmë për variantin e Këshillit të Ministrave, jo për variantin e paraqitur në seancë nga Komisioni përgjegjës i Shëndetësisë.

Të lutem, Elona, shpërndaje tek të gjithë anëtarët.

(Diskutime pa mikrofon)

Në variantin e Komisionit të Shëndetësisë kemi 2 paragrafë të neni 3, sepse është hequr paragrafi 2.

Ndërkohë, po e lexoj të gjithë nenin 3.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me siguri e keni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju nuk keni marrë pjesë në diskutimet e projektligjit në Komisionin e Shëndetësisë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po variantin e paraqitur në seancë parlamentare...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Meqenëse i gjithë diskutimi është për nenin 3, po e lexoj.

(Diskutime pa mikrofon)

Varianti i komisionit:

Në nenin 3 thuhet: “Në nenin 9, pas paragrafit të parë shtohen paragrafët me përmbajtje si më poshtë vijon: “Duke përjashtuar rastet si më poshtë vijon: a – importimin e kripës ushqimore të pajodizuar vetëm me qëllimin e fortifikimit të kripës me jod nga subjekte të licencuara për këtë qëllim, sipas legjislacionit në fuqi për licencimin, si dhe me qëllim

prodhimin e ushqimeve të destinuar për eksport, sipas germës “b” të këtij neni, duke garantuar gjurmueshmërinë e kripës së jodizuar.

(Diskutime pa mikrofon)

Në paragrafin e dytë thuhet: “Eksportimi i kripës së pajodizuar dhe ushqimet e prodhuara me krip të pajodizuar, duke garantuar gjurmueshmëri në procesin e eksportit”.

Me sa kuptoj unë, shqetësimin tuaj në lidhje me pjesën se ku do ta gjejë industria e eksportit kripën e pajodizuar, përveçse duke e gjetur në vend, e zgjidh paragrafi i versionit të Këshillit të Ministrave, sepse thotë: “Lejohet importimi i kripës së pajodizuar, me qëllim fortifikimin nga subjektet e recensuara për këtë qëllim dhe nga subjektet e pikës b, (nga eksportuesit) të cilët e përdorin për prodhimin e ushqimeve me krip të pajodizuar me destinacion eksportin”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në germën b thuhet: “Lejohet eksportimi i kripës së pajodizuar dhe i ushqimeve të prodhuara me krip të pajodizuar, duke garantuar gjurmueshmëri në procesin e eksportimit”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Roland, te pika a thuhet: “Lejohet importimi i kripës ushqimore të pajodizuar vetëm me qëllim fortifikimin e kripës me jod nga subjektet e licencuara për këtë qëllim, sipas legjislacionit në fuqi për licencimin, si dhe me qëllim prodhimin e ushqimeve të destinuar për eksport, sipas germës “b” të këtij neni, duke garantuar gjurmueshmërinë.

(Diskutime pa mikrofon)

Berti, ju lutem, të mbaroj fjalën!

(Diskutime pa mikrofon)

Nëse e nxjerrim pikë më vete:

a – “Lejohet importimi i kripës së pajodizuar për qëllim fortifikimin”.

b – “Lejohet importimi i kripës ushqimore të pajodizuar me qëllim prodhimin e ushqimeve të destinuar për eksport, (sipas germës “c” të këtij neni) duke garantuar gjurmueshmërinë”. Pra, i lejon edhe eksportuesit ta importojnë, me qëllim riekportimin.

Alban Zusi – Kam një objeksion, sepse kështu diskriminojmë prodhuesit vendas, që e përdorin kripën për qëllime teknologjike, por vetëm për tregti brenda vendit. Për shembull, përpunuesit e lëkurës. Ne kemi përpunues lëkure që e kanë me cikël të mbyllur, e regjin lëkurën, e shpëllajnë, e përpunojnë dhe bëjnë ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Alban, më korrigjoni nëse jam gabim, por ky ligj nuk është për kripën në përgjithësi, por për kripën që përdoret në industrinë e ushqimit.

Alban Zusi - Pikërisht këtu është handikapi. Kripa e ushqimit është futur si histori edhe në industri. Një formulim definitiv do të ishte që ta lëmë siç është paragrafin e parë. Kjo ka të bëjë me industrinë përpunuese të kripës, që kanë të bëjnë me konsumatorin, sepse ato kanë të bëjnë me konsumatorin përgjithësisht, ndërsa formulimi i dytë do të ishte: “Lejohet edhe importi i kripës që është i destinuar për procese teknologjike industriale, të cilat ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka lidhje me këtë ligj. Ky është ligj për kripën ushqimore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Alban Zusi – Absolutisht.

Niko Peleshi – Nuk ka lidhje me këtë ligj.

Alban Zusi – Provoni të shkoni në doganë dhe do të shikoni çfarë ndodh. AKU-ja nuk të lejon ta fusësh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, po, nëse nuk është e jodizuar, nuk e fusim dot.

Ne duam ta përdorim për industrinë vendase, sepse përveç industrisë së peshkut, që e përpunon dhe e eksporton, ne kemi edhe industrinë e përpunimit të zorrëve të sallamit, që jam unë drejtpërdrejt. Unë përpunoj zorrë sallami, eksportoje dhe furnizoj të gjithë industrinë vendase me këtë lloj produkti, i cili është i kriposur dhe në momentin kur shkon në fabrikën e sallamit, ai shpëlahet, se nuk e përdor njeri zorrën me kripë.

Niko Peleshi – Të lutem, Alban! Drini, të lutem! Të mos e bëjmë si pazar peshku!

Ky është një ligj për kripën ushqimore. Në qoftë se ka ndonjë problem teknik, siç thotë zoti Pëllumbi, që mund të jetë i njëjti kod doganor dhe u nxjerrin probleme në doganë edhe atyre që sjellin kripë për ndërtim, atëherë do të merremi ne me këtë punë. Kjo nuk është puna juaj. Do ta rregullojmë ne.

Unë mendoj se në qoftë se vjen në doganë një kripë për rrugët, nuk është kripë ushqimore, nuk i nënshtrohet këtij ligji dhe logjikisht nuk ka pengesë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si ka funksionuar deri më sot?

Alban Zusi – Po u përmend fjala kripë në doganë....

Niko Peleshi –Në dijeninë time, nuk është penguar asnjë importues i kripës joushqimore. Është ndaluar importuesi i kripës ushqimore, kur e pasur të pajodizuar, si rasti i zotit Lena.

Nuk kemi asnjë rast... Si ka funksionuar 30 vjet?

Alban Zusi – Jemi bllokuar edhe ne disa herë, me ditë të tëra.

Niko Peleshi – Ju jeni operatorë ushqimorë. Një importues i kripës për regjien e lëkurave apo për rrugët nuk është penguar ndonjëherë.

Alban Zusi – Absolutisht, po vajte në pikën doganore me fjalën kripë, ai pengohet dhe kërkon lekët! Nuk kalon dot.

Niko Peleshi – Këtë po e mbajmë shënim dhe do ta sqarojmë.

Zoti Baraj ka diçka për të thënë.

Besnik Baraj – A mund të rregullohej kjo duke thënë se ky ligj nuk u nënshtrohet rasteve kur kripa e importuar përdoret për qëllime industriale, si rrugë e të tjerë?

(Diskutime pa mikrofon)

Pra, të futet... Beqaj mund të na ndihmojë përsëri.

Ilir, a mund të shtohet një nen përjashtues, që sqaron se ky ligj nuk u nënshtrohet rasteve kur kripa e importuar është për shtrimin e rrugëve apo regjien e lëkurave, pra joushqimore?

Ilir Beqaj – Duhet të pyesim juristët, se është një fjali që nuk shkon.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Besnik Baraj - E rregullojnë juristët.

(Diskutime pa mikrofon)

Zef Shtjefni - Nuk e di se si do të funksionojë nëse ky ligj do të ketë edhe fuqi prapavepruese, se ka edhe një problem: kërkesa për kripën e jodizuar ka qenë në ligj në vitet 2008-2009. Gjithë këto vite, gjithë industria ka punuar me kripë të pajodizuar, se nuk ia ka kërkuar njeri. Tani ka filluar ta kërkojë të jodizuar. Pra, ka shumë kripë dhe shumë produkte në treg, që industria ushqimore i ka përdoruar me kripë të pajodizuar.

Nëse në ligj biem dakord që kripa e pajodizuar mund të përdoret, atëherë duhet të ketë edhe fuqi prapavepruese për produktet ushqimore që janë në treg dhe nuk kanë pasur nevojë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e di si është...

Alban Zusi – Unë mendoj se një formulim i përshtatshëm do të ishte: “Lejohet importimi i kripës së pajodizuar nga industritë përpunuese ushqimore ose joushqimore, të cilat e kanë si pjesë të procesit teknologjik të konservimit, nuk e çojnë te konsumatori fundor dhe kjo kripë nuk është e destinuar për produkte që shkojnë te konsumatori fundor.” Në këtë formë evitojmë përdorimin e kripës së pajodizuar nga dikush që bën djathin apo sallamin, që ne do të donim t’ia çonim konsumatorit fundor.

Së dyti, përjashtimin e eksporteve, sepse duke thënë “përjashtojmë eksportet”, automatikisht ia kemi lënë përgjegjësinë e kontrollit të kripës vetëm atij vendi që kërkon që kripa të jetë e jodizuar. Pra, duke thënë: “Kur kripa përdoret si pjesë e procesit teknologjik në rolin e konservantit ose kur është pjesë e produktit të eksportueshëm.” Këto të dyja mund t’jua shkruajmë, t’jua sjellim të formuluar edhe me shkrim, siç e mendojmë ne. Ky është koncepti, pra...

Niko Peleshi – Dakord.

Alban, bëjeni propozimin si e mendoni.

Unë mendoj se me variantin e Komisionit të Shëndetësisë, mbase duke e nxjerrë edhe si pikë më vete, siç e tha dhe zoti Pëllumbi, që të mos jetë më ekuivok, adresohet problemi juaj kryesor.

Tani pyetja që kam (se këtu nuk u theksua) është: a ka ndonjë pretendim nga ju për prodhimin ushqimor vendas me kripë të pajodizuar?

Pra, a pretendoni ju që një kategori mallrash, produktesh ushqimore, edhe për tregun vendas, duhet të lejohet të mos jodizohet, siç e kishte varianti i Këshillit të Ministrave? Pra, me një udhëzim të ministrit mund të hartohet një listë produktesh që përjashtohen nga domosdoshmëria e përdorimit të kripës së jodizuar.

Alban, në variantin e Komisionit të Shëndetësisë kjo është hequr, pra kjo hapësirë mbyllet.

A e keni ju këtë pretendim?

Roland Kristo – Minimalisht, janë të gjitha prodhimet e peshkut me origjinë nga deti. E kanë vetë jodin brenda, siç përmenda edhe rastin e karkalecit. Karkaleci i detit e ka 375 miligramë në 100 gramë. Netoja ditore e njeriut është 175 miligramë në ditë. 100 gramë karkalec ka 375 miligramë... Nevoja ditore është 175. Pra, ha 100 gramë dhe për dy ditë je në rregull. Normalisht, kjo vlen dhe për të gjitha llojet e tjera. Disa e kanë 100... Pra, 100 gramë peshk, merluc barbut, e ka... Është për prodhimet e peshkut me origjinë nga deti, jo nga... Kjo mund të bëhet me udhëzimin e përbashkët të dy ministrave. Kjo ishte e para.

Së dyti, duhet bërë një ndërhyrje edhe te neni 17 i kundërvajtjeve, sepse neni 17 e quan kundërvajtje përdorimin, pra duhet shtuar “me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë ligj”, se ndryshe... Këtu e lejojmë, te neni 17 vendosen gjrobat, te ligji në fuqi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Alban Zusi – Po i formulojmë dy paragrafët dhe i sjellim te ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Zoti Shtjefni...

Zef Shtjefni – Meraku ynë është: përveç jush, që jeni grup interesi, të tjerët, që nuk kanë ardhur, edhe sikur të bëhet ndonjë rregullim tjetër, a janë dakord? Një pjesë e madhe nuk ka ardhur. Ju jeni 2 përfaqësues të një... Po të tjerët?

Sikur të bëhet kjo që thoni ju, a do të bien dakord ata? Se ata mund të jenë më shumë se ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mund të kenë pretendime të tjera. Ne jemi njerëz të ligjit. Ne vërtet jemi dakord dhe po ju mbështesim, por çfarë do të bëhet me pjesën tjetër?

Faleminderit!

Alban Zusi – Është shumë e drejtë vërejtja dhe me shumë vend! Ky është një pretendim që e kemi pasur edhe herë të tjera, kur ndoshta nuk kemi qenë prezentë. Kështu që e vlerësojmë...

Unë besoj se me paragrafin e parë ky ligj i jep zgjidhje problemit të deformimit të tregut, që kishte ndodhur në fushën e përpunuesve të kripës për përdorim të konsumatori. Kishte një deformim të tregut për shkak se disa operatorë nuk mund të fusnin kripë të pajodizuar nga jashtë për ta jodizuar, fortifikuar dhe për të bërë veprimet e tjera dhe i gjithë tregu ishte i varur vetëm nga një operator. Besoj se ka zgjidhur një ndër problemet e mëdha: mosdeformimin e tregut.

Për sa u përket industrive të tjera, industria kryesore që përdor kripën në vend është industria ushqimore. Në industrinë ushqimore pjesën e luanit të përdorimit të kripës e kanë 10,12 apo 20 industri kryesore, duke përfshirë edhe atë të lëkurës, ndoshta mund të bëhen 30. Me këto rregullime që po propozojmë, pra duke futur një paragraf për lejimin e kripës së pajodizuar për efekt të përpunimeve teknologjike industriale në rolin e konservantit, themi se të gjitha këto janë zgjidhur. Duke e qartësuar, jo duke e lejuar, që ky ligj nuk prek përdorimin e kripës për qëllime joushqimore, kemi përjashtuar edhe pjesën e kripës për shtrimin e rrugëve apo për gërryerje, sepse përdoret edhe në disa teknologji të tjera, atëherë automatikisht besoj se u kemi dhënë zgjidhje të gjitha grupeve të interesit.

Këtu kemi lënë të papërfshirë pjesën e industrive ushqimore, siç janë sallameritë, fabrikat e djathit, fabrikat e konservimit, të cilat domosdoshmërisht ngelen të përjashtuara dhe duhet ta përdorin kripën e jodizuar në atë nivel që ato e përdorin për ta dërguar te konsumatori, pra është një mënyrë për t'ia transmetuar konsumatorit.

(Diskutime pa mikrofon)

Po, është shumë e drejtë, kjo nuk na kishte vajtur në mendje.

(Diskutime pa mikrofon)

Ndoshta, duhet përfshirë edhe tek ushqimi për blegtorinë.

Niko Peleshi – Ne duhet të kemi parasysh një gjë, ky ligj është për të forcuar kontrollin dhe domosdoshmërinë për përdorimin e kripës së jodizuar për shkak të deficiencës jodike që ne kemi, pra nuk mund të shkojmë prapa me këtë ligj. Ky ligj ka ardhur këtu për të impaktuar pozitivisht nivelin e jodit, pasi ne e kemi shumë të ulët nivelin e jodit krahasuar me normën.

Dëgjova zotin Beqaj, i cili u shpreh se është një tip moratoriumi, por nuk është tamam moratorium, se të gjitha vendet e kanë përdorur, disa e përdorin për të adresuar deficiencën jodike, ndërsa disa të tjerë, nga informacionet që unë kam, e përdorin për parandalim, për të mos ulur nivelin e jodit në popullatë. Kam lexuar që edhe Danimarka ka marrë masa të tilla për kripën ushqimore të buka dhe dy-tre produkte të tjera, duke e bërë kripën me domosdoshmëri të jodizuar. Ne nuk jemi duke e ekzagjeruar në këtë drejtim, por këto përjashtime nuk duhet të deformojnë qëllimin e ardhjes së këtij ligji në parlament, nuk duhen bërë hapa mbrapa, mund të bëjmë rregullime. Sa i takon eksportit, për prodhimet që tregtohen në Bashkimin Europian nuk kemi pse të aplikojmë kërkesat që kemi për tregun vendas. Këtu mund të ketë deficiencë jodike, ndërsa atje nuk ka, kështu që nuk kemi arsye pse ta djegim kot industrinë.

Alban, të lutem, mendimet të jenë sa më të shkurtra. Ndërkohë, ne do të komunikojmë edhe me operatorë të tjerë. Prania e përfaqësuesve të Ministrisë së Bujqësisë sot në komisionin tonë ishte diçka shumë e mirë dhe çdo gjë që ata kishin ne e mbajtëm shënim.

Relator i këtij projektligji është zoti Baraj, prandaj do t'ju lutesha që pretendimet dhe formulimet që keni t'i pasqyroni me shkrim.

Gjithashtu, do të kemi një takim të përbashkët me Komisionin e Shëndetësisë, por edhe me institucionet e shëndetit publik dhe më pas do të konkludojmë në një rekomandim final tonin.

Zef Shtjefni – Nëse do të doja që të mbetej diçka në mendjen e të nderuarve deputetë nga i gjithë diskutimi ynë, dy janë kriteret që dua t'ju them.

E para, të përjashtohen subjektet që e përdorin kripën në produktin përfundimtar, por edhe që eksportohet.

E dyta, të përjashtohen subjektet që e përdorin kripën në faza të caktuara të procesit dhe më pas kjo kripë shpëlahet, pra nuk ngelet në produktin përfundimtar.

Niko Peleshi – Faleminderit!

Ndërkohë, ne duhet të sqarojmë edhe çështjen e kripërave të tjera, jo për industrinë ushqimore. Pra, sipas kuptimit të këtij ligji bëhet fjalë vetëm për kripën ushqimore të

pajodizuar apo të jodizuar, ndërsa kripërat e tjera përjashtohen. Unë nuk jam jurist, por në jurisprudencë, zoti Shtjefni, e di më mirë, një gjë nuk ndalohet, lejohet. Përderisa kripa joushqimore nuk ndalohet nga ky projektligj, atëherë ajo lejohet edhe nëse nuk ka rregullim tjetër.

Kjo është çështje juristësh.

Zef Shtjefni – Nuk e di nëse Komisioni i Ligjeve e ka shqyrtuar këtë projektligj, pasi mendoj se nuk do të ishte e nevojshme të shtohen të gjitha çështjet, por besoj se me një paragraf kjo gjë mund rregullohet.

Niko Peleshi – Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA